

**UDHËZIM**  
**Nr. 14, datë 21.6.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 30.3.2020, “PËR  
PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE PËRBËRËS, FORMËN E DIPLOMËS OSE  
CERTIFIKATËS TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE  
PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË  
DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN  
SHKENCOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 91, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 30.3.2020, “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “i”, e pikës 1, të kreut II, të shfuqizohet;

b) Shkronja “n”, e pikës 1, të kreut II, të riformulohet si më poshtë:

“n) Numri i diplomës për studimet e ciklit të parë dhe për diplomat e ciklit të dytë e të tretë, numri i diplomës së studimeve universitare të përfunduara më parë /numri i regjistrit që gjendet në vërtetimin e njohjes dhe njësimit të diplomës/certifikatës së lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë.”;

c) shkronja “b”, e pikës 2, të kreut III, të riformulohet si më poshtë:

“b) Kopjen e aktit të hapjes/riorganizimit (nëse ka) dhe kopjen e aktit të akreditimit të IAL-së ose kur afati i akreditimit ka përfunduar, kopjen e dokumentit, me anë të të cilit vërtetohet aplikimi në organin kompetent për akreditimin periodik institucional.”;

d) shkronja “ç”, e pikës 2, të kreut III, të riformulohet si më poshtë:

“ç) Kopjen e aktit të akreditimit të programit të studimit për të cilin lëshohet diploma që regjistrohet ose kopjen e dokumentit me anë të të cilit vërtetohet aplikimi në organin kompetent për akreditimin periodik të programit të studimit, me përjashtim të programit të studimit për të cilin legjislacioni në fuqi nuk parashikon akreditimin e tij.”;

e) shkronja “p”, e pikës 1, të kreut II, të ndryshojë si më poshtë:

“1. Forma e studimeve dhe kohëzgjatja normale e programit të studimit”.

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT**  
**Evis Kushi**